



UDHËZUES MBI PARAQITJEN E INFORMACIONEVE MBI EVAZIONIN TATIMOR, KORRUPSIONIN, APO SJELLJEVE JO TË MIRA NGA STAFI I ATK-së

TË NDERUAR QYTETARË :

Ju keni mundësinë të paraqitni Evazionin Tatimor , si dhe veprimet Korruptive, apo Sjelljet jo të mira të Zyrtarëve të Administratës Tatimore, të cilat vërehen nga Ju!

ÇFARË INFORMACIONE DUHET TË RAPORTOHEN NË ATK ?

1. Informacione mbi Evazionin Tatimor :

- Mos regjistrim i Biznesit;
- Nëse Biznesi nuk lëshon fatura tatimore, kupona fiskal, etj;
- Nëse Biznesi bën përshkrimin e faturës me çmim më të vogël se ai real;
- Nëse Biznesi nuk mbanë tatimin në burim;
- Nëse Biznesi lëshon fatura fiktive;
- Nëse transportohen, mbahen apo shiten mallra pa dokumentacionin mbi prejardhjen;
- Nëse punëdhënësi nuk ju ka deklaruar si punëtor ,apo nuk i ka deklaruar të gjithë të punësuarit;
- Nëse Biznesi ka lidhur kontratë me qellim të krijimit të Evazionit Tatimor;
- Nëse Biznesi nuk e ka instaluar Pajisjen Elektronike Fiskale, ashtu si është kërkuar nga ATK-ja, apo manipulon me Pajisjen Elektronike Fiskale;
- Informacione tjera, që kanë të bëjnë me Evazion Tatimor.

2. Informata mbi korrupsionin, apo informata mbi sjellje jo të mira për ndonjë zyrtar të ATK-së, që vlerësoni se janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi:

- Nëse ndonjë zyrtar i ATK-së, kërkon mito, apo ndonjë favor;
- Nëse dikush kërkon ndonjë favor në emër të ATK-së;
- Nëse ndonjë zyrtar i ATK-së, ka për qëllim diskriminimin;
- Nëse ndonjë zyrtar paraqet arrogancë ndaj jush, duke shfrytëzuar autoritetin e ATK-së;
- Nëse ndonjë zyrtar shfrytëzon pasurinë e ATK-së, për përfitime personale;
- Nëse keni njohuri se Zyrtari i ATK-së, është duke mbajtur librat e Kontabilitetit të ndonjë subjekti;
- Nëse ndonjë zyrtar kryen vizita tendencioze dhe të pa bazuara në ligj;

SI MUND TI DËRGOJMË INFORMATAT?

- I. Përmes linjës online të bashkëpunimit pa pagesë 0800-80-800;
- II. Në Drejtorinë e ATK-së, në Zyrën e Standardeve Profesionale;
- III. Në e-mail adresën:
standardet.profesionale@atk-ks.org
- IV. Në kutitë e vërejtjeve dhe sugjerimeve, të cilat i gjeni të vendosura në të gjitha regjionet:
 - Zyren Qendrore;
 - Prishtina 1 dhe Prishtina 2;
 - Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj (NJTM);
 - Regjionin e Mitrovicës ;
 - Regjionin e Gjilanit;
 - Regjionin e Ferizajt;
 - Regjionin e Gjakovës;
 - Regjionin e Pejës;

SI DO TË PËRPUNOHEN KËTO INFORMATA ?

Administratat Tatimore e Kosovës, ka autoritetin dhe zyrat e veçanta që do të ndihmojnë në zbardhjen e rasteve, kur dyshohet që ka Evazion Tatimor dhe Keqpërdorime të autoriteteve të ATK-së. Njëherësh ATK-ja, siguron të gjithë qytetarët, se nëse paraqitni ndonjë rast, Ju nuk do të identifikoheni dhe se të dhënat e juaja mbeten vetëm për organet përkatëse (konsiderohen konfidenciale).

ÇKA DO TË PËRFITOHET?

Përmes zbulimit të këtyre dukurive, Ju do të kontribuoni në rritjen e buxhetit të Republikës së Kosovës, i cili mund të ofrojë:

- Shkollim më të mirë;
- Infrastrukturë më të mirë;
- Pensione dhe paga më të larta;
- Shërbime më të mira shëndetësore;
- Siguri më të lartë;
- Konkurrencë të barabartë, etj.

LINJËS SË BASHKËPUNIMIT PA PAGESË

NGA:  dhe 



0800-80-800